

*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.01.2023*

14.01.2023  
Ora 09:00

**RENDI I DITËS**

**Projektvendim “Për përzgjedhjen e monitoruesve për Bashkinë Gjirokastrë dhe Delvinë, për zgjedhjet e organeve të qeverisjes vendore, të datës 14 maj 2023”.**

**PJESËMARRJA :**

• **KQZ**

**1. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**2. Stafi KQZ:**

**Z. Y. Merkaj, Z. K. Puleri**

• **Parti Politike:**

• **OJQ:**

**Z. Y. Merkaj:** Përshëndetje të gjithëve, sot në datën 14.01.2023, ora 9:00 do të zhvillohet procedura e shortit për caktimin e dy monitoruesve në Bashkinë e Gjirokastrës dhe një monitoruesi në Bashkinë e Delvinës. Pasi është bërë publik njoftimi në faqen zyrtare të KQZ-së, kësaj thirrje i janë përgjigjur tre aplikantë për Bashkinë Gjirokastrë dhe dy aplikantë për monitorues në Bashkinë Delvinë. Shorti do të hidhet ndërmjet këtyre aplikantëve. Në Bashkinë Gjirokastrë kanë aplikuar tre aplikantë të cilët plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 03, datë 03.11.2022 dhe dy aplikantë për Bashkinë Delvinë. Procedura e shortit është e njejtë si procedurat e kaluara. Në një enë transparente do të vendosim tre shirita letre për Bashkinë e Gjirokastrës me emrat e aplikantëve të cilat do të futen në tre gogla me peshë, ngjyrë, formë dhe madhësi të njejtë dhe më pas në një enë transparente. Lexojmë emrat e aplikantëve:

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*



*Procesverbali i zbardhur i seancës publike të  
Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve  
Dt.14.01.2023*

1.Arjan Gjini;

2.Amarda Shalari;

3.Adela Kale është aplikantia e tretë për Bashkinë e Gjirokastrës.

Një përfaqësues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve do të përziejë goglat. Dy emrat e parë që do të tërhiqen nga përfaqësuesi i KQZ-së do të jenë monitoruesit e Bashkisë Gjirokastrë për fushatën zgjedhore të zgjedhjeve vendore të 14 majit 2023.

1. Amarda Shalari;

2. Adela Kale është monitoruesja e dytë.

Për transparencë hapim goglen e tretë dhe rezulton që Arjan Gjini është aplikanti i cili nuk ka fituar.

Vazhdojmë me procedurën për Bashkinë e Delvinës. Aplikantët janë:

1.Ornela Çollaku;

2.Ëngjëllushe Haxhi.

Shiritat e letrës futen në goglat me ngjyrë, peshë dhe formë të njejtë në një enë transparente. Pasi përziejhen nga përfaqësuesi i KQZ-së, tërhiqet gogla dhe:

Ornela Çollaku është monitoruesja për Bashkinë e Delvinës.

Kjo ishte procedura e shortit për ditën e sotme, ju faleminderit!

**Vendimi nr. 14**

*Zbardhi materialin audio  
Merita DULAKU*

